



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 36, datë 09.05.2022

**PËR**

**MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE RRASHBULL, RRUGA "GJON KASTRIOTI" PALLATI NR. 39, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" (Titulli 3, Bashkëpronësia, Neni 199 dhe vijues), të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 202, datë 05.03.2020 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të banesave individuale", Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e komsionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit", i ndryshuar, të raportit të Komisionit të Posaçëm miratuar nga titullari i institucionit me nr.471/26 prot., datë 26.04.2022, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e listës së përfituesve, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr. 39, Rruga "Gjon Kastrioti" në Njësinë Administrative Rrashbull, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019, hartuar nga Komisioni i Posaçëm sipas aneksit 1 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 10.05.2022**

**ANEKSI 1. SUBJEKTET PËRFITUESE TË PALLATIT NR.39, RRUGA "GJON KASTRIOTI"**

<b>Nr.</b>	<b>PRONARI</b>	<b>GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES</b>	<b>STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET</b>
1	XHEMAL HYSENI, ALIFE HYSENI	3	2+1
2	ASIM HAXHIU, GJYSLIME HAXHIU, LILJANA HAXHIU, LULI HAXHIU, MANUSHAQE HAXHIU	6	3+1
3	LEONARD ÇUKA	6	3+1
4	HAKI ZAMAKU	7	3+1
5	PELLUMB JAÇE, KIPE JAÇE, TOMORR JAÇE	2	1+1
6	GEZIM HAJRO, HATIXHE HAJRO	4	2+1
7	ISMETE BERBERI, LUTFI BERBERI	5	3+1
8	LUTFI HOXHA, AFERDITA HOXHA	2	1+1
9	MUSA MUSAI, PRANVERA MUSAI	2	1+1
10	MEZAN ÇUKA, SALO ÇUKA, BESIM ÇUKA, LINDITA ÇUKA	5	3+1
11	HAJRIJE HAJRO, SADETE HAJRO, MURAT HAJRO, BEHARE HAJRO	3	2+1
12	GEZIM HAJRO	4	2+1





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 PREFEKTI QARKUT Durrës

Nr. 427 / prot.

4



Durrës, më 16 05 .2022

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
 DURRËS**

**BASHKISË DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.36 datë 09.05.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative Rrashbull, Rruga “Gjon Kastrioti” Pallati nr 39, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

